



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
SENATI AKADEMIK

Nr. 2553/prot.
6

Tiranë, më 27/09/2019

VENDIM

Nr. 57, datë 27.09.2019

PËR

**NISJEN E PROCEDURAVE PËR KRIJIMIN E KOMISIONIT TË PËRHERSHËM PËR
DHËNIEN E GRADËS SHKENCORE “DOKTOR” NË NIVEL NJËSIE KRYESORE NË
UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË, DHE NISJEN E PROCESIT ZGJEDHOR PËR
ZGJEDHJEN E ANËTARËVE TË TIJ**

Në bazë të nenit 3, 38, 46 e vijues ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, të nenit 32, 35 e vijues të Statutit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, Rregullores së nxjerrë nga Ministria e Arsimit dhe Sportit me nr. 2459/1 prot., datë 15.03.2016 “Për organizimin e zgjedhjeve të para për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe pas diskutimeve sipas rendit të ditës, Senati Akademik,

VENDOSI:

1. Të nisë procedurat përkatëse për krijimin e Komisionit të Përherëshëm për Dhënie e Gradës Shkencore “Doktor” në nivel njësie kryesore në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, si më poshtë:
 - a. Komisioni i Fakultetit të Mjekësisë përbëhet nga 11 (njëmbëdhjetë) anëtarë.
 - b. Komisioni i Fakultetit të Mjekësisë Dentare përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë.
 - c. Komisioni i Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike përbëhet nga 7 (shtatë) anëtarë.
2. Anëtarët e këtij komisioni janë personel akademik me kohë të plotë i njësisë kryesore përkatëse, të cilët i përkasin kategorisë “Profesor”. Ata vetëkandidohen dhe zgjidhen nga asambleja e personelit akademik të njësisë kryesore me një mandat 2 (dy) vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.
3. Kriteret që do të plotësojnë kandidatët do të përcaktohen sipas legjislacionit në fuqi.
4. Ngarkohen njësitë kryesore dhe Komisioni Institucional Zgjedhor (KIZ) në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, të fillojnë procedurat përkatëse për zgjedhjen e anëtarëve të këtyre komisioneve sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.
5. Vendimi i Senatit Akademik nr.59, datë 16.10.2018 “Për krijimin e Komisionit të Përherëshëm...”, shfuqizohet.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
ARBEN GJATA

